



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010 dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Kryeqytetit,

**th ë r r e t**

mbledhjen e **pestë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **11.6.2024** dhe do të fillojë në orën **8:30**.

Mbledhja do të mbahet në sallën nr. 37 (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë:

**REND TË DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendimi për rritjen dhe bartjen e mjeteve nga tejkalimi i planit për të hyra vetjake nga viti 2023 në vitin 2024;
3. Propozim-vendimi për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024;
4. Propozim-vendimi për transferimin e mjeteve;
5. Propozim-vendimi për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me emrin e humanistit Dr. Gani Demolli;
6. Propozim-Vendimi për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), 2024-2032;
7. Propozim-vendimi për themelimin e Komisionit të Kuvendit lidhur me shfrytëzimin e Banesave të Komunës së Prishtinës në Bregun e Diellit, Fusha e Pajtimit dhe në Hajvali;

*f.k.*

8. Raporti vjetor i punës së Ndërmarrjes publike lokale "Gjelbër" SHA, për vitin 2023, si dhe raporti i punës për periudhën janar-prill 2024;
9. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-060/01-70016/24, më 30.5.2024

KRYESUES I KOMITETIT  
Fehmi Kupina



---

Faqe 2 nga 2

*F.K.*

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 381(0)38/230-900  
<http://www.pristina-komuna.org>